

**DOKUMENTET E NEVOJSHME PER APLIKIM TË KANDIDATËVE SHTETAS
TË HUAJ PER TE DY CIKLET E STUDIMIT**

VITI AKADEMIK 2022-2023

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE SHTETAS
TË HUAJ ME DIPLOMA TË HUAJA TË SHKOLLËS SË MESME, NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË CIKLIT TË
PARË DHE TË DYTË STUDIMEVE *TË INTEGRUAR*, NË PROGRAMET E STUDIMEVE
ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË

1. Të gjithë **kandidatët shtetas të huaj** me diploma të huaja të shkollës së mesme që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10

Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

* **Studentët e huaj** duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1- formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;
- 2- kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave, të njehsuar nga QSHA-ja;
- 3- fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
- 4- dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe;
- 5- dy fotografi personale;
- 6- kopjen e mandatpagesës;
- 7- autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr.3 për Ciklin e Parë dhe shtojcës nr.6 për Ciklin e Dytë, të këtij udhëzimi.

Shtojca nr. 2

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institutin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i i kandidatit

Emër Atësi i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . _____

Shtojca nr. 3

Data: ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë / profesional / integruar i ciklit të dytë _____ në IAL _____.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët

a) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- Republika e Kosovës;
- Mal i Zi;
- Maqedonia e Veriut;
- Preshevë;
- Bujanovci;
- Medvegja;

b) e huaj

Me shtetësi _____

Gjuhë amtare _____

Me arsim të mesëm _____

Adresë aktuale _____

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik në vijim.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Shtojca nr. 6

Data: ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____,
Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë / tretë:

- “Master profesional”
- “Master i shkencave”/ “Master i arteve”
- “Master Ekzekutiv”

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit

B. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- Republika e Kosovës;
- Mal i Zi;
- Maqedonia e Veriut;
- Preshevë;
- Bujanovci;
- Medvegja;

C. Nga kategoritë e veçanta (PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):

_____.

D. Shtetas i huaj

Gjuha amtare _____ . Shtetësia _____

Emri i universitetit _____

6. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

7. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

8. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t’u regjistruar, periudhën e

studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

9. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

10. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit

Firma

Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma

